

Procesverbal i përmbledhur i mbledhjes së mbajtur më 06.01.2016

Rendi i ditës

1. Shqyrtimi i përgjithshëm i gjendjes në kolegji (vazhdim nga mbledhja e datës 25.11.2015)
2. Raporti mbi gjendjen e përgjithshme në Kolegji i kryetarit të Këshillit z.Andi Belegu
3. Planifikimi i ardhshëm i aktiviteteve të Këshillit të Studentëve (vazhdim nga mbledhja e datës 25.11.2015)

Në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e Këshillit të Studentëve të Kolegjit duke përfshirë edhe anëtarët e rinj të zgjedhur nga gjeneratat.

Në pikën e parë u prezentuan raportet interne të secilit përfaqësues të gjeneratës mbi gjendjen në Kolegji, u prezentuan disa pika të cilat mbet të shqyrtohen bashkë me udhëheqësinë e Kolegjit dhe Administratës mbi disa pakënaqësi të vogla të studentëve. Në përgjithësi raportet paraqitnin një performancë të kënaqshme të stafit akademik dhe administrativ. U dakordua për adresimin e këtyre të gjeturave të Këshillit me një letër zyrtare që u komunikua tek të gjithë studentët dhe më pas u planifikua një takim me drejtorin e Kolegjit me qëllim të zgjidhjes së këtyre çështjeve.

Gjatë kësaj mbledhje dha raportin edhe kryetari i Këshillit z. Andi Belegu i cili prezntoi pikëpamjet e tij dhe të gjeturat që nxorri nga komunikimi me kryesinë e Këshillit dhe dhe studentët tjerë të Kolegjit.

U propozuan disa aktivitete si mbrëmje shoqërore, aktivitete akademike që përfshijnë klube të leximit dhe diskutimit, klube të debatit dhe aktivitete të tjera që lidhen me aktivitetin e përditshëm në Kolegji. Aktivitetet u aprovuan dhe mbeti që jashtë mbledhjes të organizohen dhe diskutohen veç e veç.

Procesverbalin e mbajti Albion Sutaj – Nënkryetarë i Këshillit të Studentëve të Kolegjit ESLG.

Andi Belegu

Kryetar i Këshillit